

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëritë Enmon d.o.o. Beograd me seli të regjistruar në Bulevar Osloboxhenja 205, 1100 Beograd, Serbi dhe Alteria EOOD me seli të regjistruar në Slavjanska 5, kati 3, 1000 Sofje, Bullgari përmes Andrea Lazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 16.07.2025, solli këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Enmon d.o.o. Beograd me seli të regjistruar në Bulevar Osloboxhenja 205, 1100 Beograd, Serbi dhe Alteria EOOD me seli të regjistruar në Slavjanska 5, kati 3, 1000 Sofje, Bullgari do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Keramika Kanjizha me seli të regjistruar në Horgoshki put bb, 24420 Kanjizha, Serbi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më 30.05.2025, dhe e plotësuar më 25.06.2025 dhe 02.07.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga Enmon d.o.o. Beograd me seli të regjistruar në Bulevar Osloboxhenja 205, 1100 Beograd, Serbi dhe Alteria EOOD me seli të regjistruar në Slavjanska 5, kati 3, 1000 Sofje, Bullgari, me të cilin Enmon d.o.o. Beograd dhe Alteria EOOD do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Keramika Kanjizha me seli të regjistruar në Horgoshki put bb, 24420 Kanjizha, Serbi.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimin të tij dhe, mbi bazën e të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, të shtojcave të tij dhe të dhënave të dorëzuara shtesë, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet themelore të ndërmarrjeve të përfshira:

- **Enmon d.o.o. Beograd** është pjesë e grupit Enmon, i cili është aktiv në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të pllakave qeramike, qeramikës granit, sanitareve dhe pajisjeve të lidhura për banja, ndërtesa publike dhe të banesave. Grupi ka mbi 1.200 të punësuar në tetë shtete dhe siguron sistem të plotë për instalimin e qeramikës me të gjithë materialet përcjellëse.

Është aktiv në tregjet në Serbi, Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni të Veriut, Hungari, Gjermani, Itali dhe Kanada.

Asortimenti bazë në sallone përfshin: pllaka qeramike dhe graniti; njësi sanitare; kabina dushi; vaska dhe bojlerë; mobilje dhe pasqyra për banja; materiale për përgatitje dhe montim; ngrohje dhe ftohje (si dhe zgjidhje për drenazh) dhe aksesore për banjë.

Përveç këtyre veprimtarive, grupi Enmon merret edhe me ndërtimin e ndërtesave në një segment më të vogël.

Enmon d.o.o. Beograd është aktiv në Maqedoninë e Veriut përmes këtyre dy shoqërive të lidhura:

-Shoqëri për tregti dhe shërbime transporti ENMON import-eksport SHPKNJP Veles me seli në rr. Oliver Kitanovski nr. 119 Veles dhe veprimtari të regjistruar – tregti me shumicë me dru, materiale ndërtimi dhe pajisje sanitare dhe

-Shoqëri për autotransport dhe tregti ENMON-TRANSPORT import-eksport SHPKNJP Veles me seli në rr. Oliver Kitanovski nr. 119 Veles dhe veprimtari të regjistruar – transport rrugor mallrash.

Shoqëria për tregti dhe shërbime transporti ENMON import-eksport SHPKNJP Veles dhe Shoqëria për autotransport dhe tregti ENMON-TRANSPORT import-eksport SHPKNJP Veles shesin mallra dhe gjenerojnë të ardhura në Maqedoninë e Veriut, ndër të tjera edhe nga shitja e pllakave qeramike.

-Alteria EOOD operon në kuadër të grupit të shoqërive SPSC Invest, i cili bashkon një numër të madh shoqërish të përfshira në veprimtari të ndryshme. Alteria EOOD nuk ka shoqëri të lidhura, filiale ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, por realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes së mallrave, përkatësisht shitjes së pllakave qeramike.

-Keramika Kanjizha është prodhues serb i pllakave qeramike, i cili operon në treg tash 40 vjet. Shoqëria është aktive në prodhim dhe treg me shumicë, dhe në punën e saj përdor teknologji dhe makina moderne nga Italia. Ofron një spektër të gjerë produktesh, si pllaka qeramike dyshemeje dhe muri, si dhe pllaka porcelani me cilësi porcelani. Keramika Kanjizha i plasojnë produktet e veta në tregun e Serbisë dhe në vendet e Evropës Juglindore.

Keramika Kanjizha nuk ka shoqëri të lidhura, filiale ose përfaqësi në Maqedoninë e Veriut, por realizon qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjes së pllakave qeramike.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ